



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më  
27.11.2019, duke filluar në orën 11:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha i pavarur, Fiknete Bejtë (AAK), Sami Boroci (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR) dhe Rifat Deri, i pavarur.

Munguan: Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Drilon Pireva (PSD), Nol Nushi (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Bukurie Canolli (AAK), Leutrim Retkoceri (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Baton Dushi (Nisma) dhe Valbona Petrovci, e pavarur.

Të pranishëm ishin edhe: Kryetar i Komunës, Shpend Ahmeti, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të e medieve të shkruara dhe elektronike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit, dhe propozoi këtë

Rend të ditës:

1. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare, si ndihmë nga Komuna e Prishtinës, për shkak të tërmetit i cili ka ndodhur në Shqipëri.

Faqe 1 nga 3

**Kryesuesi tha se ngjarja tragjike që ndodhi ditën e djeshme në Republikën e Shqipërisë, neve si Kuvend i Komunës së Prishtinës na obligon të solidarizohemi, si dhe të diskutojmë për ndarjen e një shume të mjeteve financiare për të gjitha familjet e prekura nga ajo tragjedi.**

Para se të fillonin me diskutimet rreth rendit të ditës, kryesuesi kërkoi nga të pranishmit që të mbahet një minutë heshtje në shenjë nderimi për viktimat e rëna nga tërmeti.

**Shpend Ahmeti**, kryetar, theksoi se dita e 26 nëntorit ka qenë një ditë tragjike për të gjithë shqiptarët, kudo që janë, me një numër të viktimateve mbi 30 veta dhe një numër të konsiderueshëm të njerëzve të cilët kanë mbetur nën rrënoja, ku po punohet intensivisht për shpëtimin e tyre.

Nga dje kam qenë vazhdimisht në kontakt me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, z. Velia, ku ne kemi shprehur gatishmëri për t'i ndihmuar qytetarët e prekur nga tërmeti.

Ne sot këtu do ta propozojmë një shumë prej 50.000 euro, si ndihmë nga Komuna e Prishtinës. Po ashtu, kam diskutuar edhe me ministren e Arsimit të Shqipërisë, znj. Besa Shahini, dhe e kam informuar se Shoqata e Arkitektëve, së bashku me disa arkitektë të Prishtinës dhe rreth 15 inxhinierë të statikës, janë organizuar dhe do të shkojnë në Shqipëri për të ndihmuar në vlerësimin e dëmeve të objekteve të dëmtuara në Durrës.

**Sami Boroci** tha se të gjithë jemi tronditur nga tragedia që e kaploj Shqipërinë, edhe sot një seancë e tillë është më e pakta që ne mund ta bëjmë në këtë drejtim.

Sigurisht që pajtohem me thirrjen e kësaj seance, mirëpo duke pasur parasysh iniciativën e qytetarëve të Prishtinës, grupeve të ndryshme që janë mobilizuar me ndihmuar njerëzit e prekur nga ky termet, propozoj që të gjemë mundësinë për themelimin e një taskforce, e cila do të bëhej nga Kuvendi komunal, Komuna e Prishtinës - ekzekutivi, njerëzit përgjegjës, organizatat e ndryshme, të cilat veç janë në lëvizje për ndihmë qytetarëve të prekur nga tërmeti, si me mjete financiare, ushqimore, strehim etj.

**Agim Gashi** theksoi se si Kuvend bëmë mirë që edhe ne po kontribuojmë në dhënien e ndihmës karshi ngjarjes në Shqipëri dhe hapësirave tjera përreth Shqipërisë, sepse me këtë po e ngremë një shkallë vetëdijesimi institucional, e kjo është shumë me rëndësi. Lidhur me ngjarjet e tillë asnjëherë nuk është ngritur problemi i emergjencave në nivel kuvendar, për të biseduar në kontest të kompetencave që ka niveli komunal lidhur me zhvillimin e fushës së emergjencave.

Andaj, propozoj që në njëren nga seancat e ardhshme, jo shumë larg, ta shqyrtojmë pozicionin tonë institucional karshi kompetencave në fushën e emergjencave që i kemi.

**Kryetari i Komunës, Shpend Ahmeti, u shpreh se në njëren nga seancat e radhës të Kuvendit, do ta informojmë Kuvendin rreth kompetencave në fushën e emergjencave që i kemi.**

**Fiknete Bejta** kërkoi nga Kuvendi që ta ketë një solidaritet edhe për familjen Abazi nga rrëthina e Gjilanit, e cila i humbi dy djem në këtë fatkeqësi natyrore, që në mënyrë simbolike t'i ndahet një shumë e mjeteve financiare.

Po ashtu, u shpreh e pajtimit me propozimin e z. Gashi, që Komuna e Prishtinës ta krijojë një fond emergjent në bazë të kompetencave që i ka.

**Leonora Shabani – Bajraktari** kërkoi që nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, gjegjësish Sektori i Emergjencave, dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale, që të organizohen për sigurimin e banimit të përkohshëm për qytetarët nga Shqipëria që kanë nevojë për strehim. Vlera e mjeteve të propozuara për ndihmë, mendoj që është një shumë jo e mjartueshme, por shpresojmë që në një takim të ardhshëm të kemi një mbulesë, apo një ndihmë më të madhe nga Komuna.

Lidhur me çështjet e ngritura nga znj. Fiknete Bejta, kryetari, Shpend Ahmeti dha sqarime të nevojshme.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare, si ndihmë nga Komuna e Prishtinës, për shkak të tërmetit që preku Shqipërinë.**

Mbledhja përfundoi në ora 11:25.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**



Faqe 3 nga 3